



Deklaratë për shtyp - 525/06/2020

**Qeveria e Republikës heq masat e kufizimit të
lëvizjes për qarkun e Warendorf / Rregulloret
në lidhje me kufizimin e lëvizjes të qarkut të
Gütersloh do të vazhdojnë edhe për një javë /
Rregulloret e urdhëresës së mbrojtjes nga
koronavirusi do të zgjaten deri në 15 Korrik për
të gjithë Nordrhein-Westfalen**

29.06.2020
Faqja 1 nga 3
Zyra për shtypin e kancelarisë së
shtetit
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

**Kryeministri Laschet: Falenderime për qytetarët, kufizimet në
Gütersloh janë ende të nevojshme për të mbrojtur shëndetin**

Kancelaria e shtetit ju informon:

Qeveria e Republikës heq kufizimin e lëvizjes dhe kufizimet e jetës publike për qarkun e Warendorf duke filluar nga mesnata e së martës, 30 Qershor 2020. Për qarkun e Gütersloh, rregulloret dhe kufizimet ekzistuese do të zgjaten me një javë dhe do të vazhdojnë deri më 7 Korrik 2020. Kryeministri Armin Laschet së bashku me Ministrin e Shëndetësisë Karl-Josef Laumann dhe administratorët e qarqeve të Gütersloh dhe Warendorf, Sven-Georg Adenauer dhe Dr. Olaf Gericke informoi të hënën më 29 Qershor 2020 në lidhje me këto hapa dhe në lidhje me masat e mëtejshme dhe shpjegoi se si do procedohet. Për më tepër, rregulloret e urdhëresës për mbrojtjen nga koronavirusi do të vazhdojnë dhe për dy javë në të gjithë Nordrhein-Westfalen. Këto do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri më 15 Korrik 2020.

Kryeministri Armin Laschet: „Kemi kërkuar shumë prej njerëzve në qarqet e Gütersloh dhe Warendorf duke patur parasysh vendimet e qëllimshme të ditëve të fundit dhe implementimin në vazhdim të masave. Jemi të vetëdijshëm për këtë gjë. Prandaj ju falenderoj të gjithëve për mirëkuptimin dhe mbështetjen. Kjo vlen edhe për kryebashkiakët në vend, me të cilët ne përcaktojmë në koordinim të ngushtë përhapjen e infeksionit dhe diskutojmë masat të cilat duhen marrë.

Rezultatet e testeve më të mëdha të kryera në Gjermani që nga shpërthimi i pandemisë së koronavirusit (pothuajse 40.000 njerëz), dhe

zhvillimi i numrave të incidencës konfirmojnë veprimet tona dhe na tregojnë se vendimet tona të ndryshuara ishin të duhurat.

Gjithsesi, ditët e fundit duhet të shërbejnë si një kujtesë për të gjithë ne se virusi nuk është kapërcyer akoma dhe se duhet të vazhdojmë ta trajtojmë njëri tjetrin me kujdes dhe përgjegjësi.“

Kryeministri vazhdoi: „Nëpërmjet procedurës së përgjegjshme dhe transparente në qarqet e Gütersloh dhe Warendorf dhe zgjatjes së rregulloreve , ne po i japim qarqeve dhe qytetarëve në Nordrhein- Westfalen besueshmëri dhe parashikueshmëri.“

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann: „Zhvillimi në qarkun e Gütersloh është inkurajues. Gjithsesi, duke u bazuar tek shifrat në gatshmëri, ne nuk mund të jemi ende të sigurt se përhapja e infeksionit mund të kufizohet ekskluzivisht me shpërthimin e infeksioneve tek thertorja. Megjithëse kjo është një situatë e vështirë për qytetarët e qarkut të Gütersloh ne do të vazhdojmë të monitorojmë intensivisht nga afër situatën në qarkun e Gütersloh në ditët në vazhdim. Jam shumë mirënjohës për të gjithë të afektuarit në qarqet e Gütersloh dhe Warendorf për mirëkuptimin dhe këmbënguljen e tyre. Sigurisht, kufizimet janë jo të thjeshta, por të nevojshme.“

Administratori i qarkut Sven-Georg Adenauer: „Unë shpreh hapur mbështetjen për vendimet e marra nga Republika së bashku me personat përgjegjës në vend. Të gjitha masat e marra deri tani për qarkun e Gütersloh kanë treguar se janë të duhura dhe të nevojshme. Në të njëjtën kohë, duke patur parasysh nevojën e vazhdueshme për kujdes, është e pashmangshme që masat të zgjerohen fillimisht edhe me një javë. Është gjë e mirë që njerëzit në qark kanë tashmë një ide për sa i përket rezultateve të mira të testeve dhe kontrollimit të suksesshëm të infeksionit. Vlera e 50 infeksioneve të reja në incidencën e 7 ditëve luan këtu një rol kryesor.“

Administratori i qarkut Dr. Olaf Gericke: „Testet e shumta në qark tregojnë se virusi nuk është përhapur tek popullata e përgjithshme. Prandaj tashmë vendimi i vetëm është të hiqet sërish kufizimi i lëvizjes për qarkun e Warendorf. Ne kemi përjetuar këtu një kryevepër logjistike në ditët e fundit dhe kemi krijuar kapacitete testimi të mëdha në një kohë shumë të shkurtër. Falenderimet e mia shkojnë për të gjithë ata tek shërbimet e emergjencës të cilët kanë punuar pa u lodhur. Në të njëjtën kohë, dua të falenderoj veçanërisht qeverinë e Republikës dhe atë federale për mbështetjen e tyre, për shmangien e stigmatizimit të individëve

nga qarqet. Fatmirësisht Kryeministri Laschet dhe kancelarja Merkel kanë refuzuar shprehimisht të sulmojnë publikisht njerëzit nga qarqet. Kjo shenjë solidariteti është ndjerë tek ne.“

Faqja 3 nga 3

Kur u bë i njohur shpërthimi i koronavirusit në një thertore në Rheda-Wiedenbrück, qeveria e Republikës mori masa emergjente të vazhdueshme dhe mbylli fabrikën së bashku me shkollat dhe qendrat e kujdesit për fëmijë, duke aktivizuar fazën e dytë të kufizimit të lëvizjes më 23 Qershor 2020. Si rrjedhim, zunë vend kufizimet në rritje në jetën publike për qarqet e Gütersloh dhe Warendorf. Për shembull, vetëm dy persona ose persona nga një familje ose bashkësi familjare lejohen të takohen në një hapësirë publike. Për më tepër, një numër aktivitësh të kohës së lirë -përmbi rregulloret kombëtare të urdhëresës për mbrojtjen nga koronavirusi- duhet të anuloheshin, si për shembull, mbyllja e muzeve, kinemave, palestrave, pishinave të mbyllura dhe bareve. Këto rregullore vazhdojnë të vlejnjë për qarkun e Gütersloh.

Përtej kufizimeve të kontaktit dhe të kohës së lirë, pajtimi me masat e urdhëruara të karantinës është çelësi kryesor për të ndërprerë në mënyrë efektive zinxhirin e infeksionit. Për më tepër, me iniciativën e qeverisë së Republikës , testimi për koronavirusin është zgjeruar gjerësisht në rajonin e afektuar në mënyrë që të përcaktohet nëse koronavirusi po përhapet tek popullata. Të gjithë qytetarët e qarqeve të Gütersloh dhe Warendorf kanë gjithashtu mundësinë e kryerjes së një test falas.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw

[Njoftim i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave](#)